



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:043191

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05774186

CN.nr.14/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike jokontestimore, sipas propozimit të propozueses Sh.H nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, për shkak të dhurimit dhe heqjes dorë nga bashkëpronësia në favor të kundërpropozuesit A.SH nga Rahoveci, jashtë seancës gjyqësore, më datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË i palejueshëm propozimi i propozueses Sh.H nga Rahoveci, me numër CN.nr.14/2023, të datës 16.02.2023, për shkak të dhurimit dhe heqjes dorë nga bashkëpronësia, në favor të kundërpropozuesit A.Sh, nga Rahoveci.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesja Sh.H nga Rahoveci, pranë kësaj gjykate më datë 16.02.2023, ka parashtruar propozimin për dhurimin dhe heqjes dorë nga bashkëpronësia në favor të kundërpropozuesit A.SH nga Rahoveci.

Pas shqyrtimit paraprak të propozimit të propozueses Sh.H, lidhur me dhurimin dhe heqjes dorë nga bashkëpronësia në favor të kundërpropozuesit A.SH nga Rahoveci, gjykata gjeti se ky propozim është i pa lejuar.

Gjykata konstaton se në këtë çështje juridike nuk kemi të bëjmë me procedurën trashëgimore në të cilën është thirrur propozuesja konkretisht nenin 130 par.1 të LTK-së, i cili thotë “Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës apo Noterit, gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin” dhe par.2, “Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet”, pasi që procedura trashëgimore sipas aktvendimit CT.nr.1/2022, të kësaj gjykate ka përfunduar me datë 23.02.2022, në të cilën vendim propozuesja është shpallur trashëgimtare ligjore e të ndjerit I.A.Sh në pjesët si në aktvendim.

Gjykata konsideron se propozuesja nuk mund të heqë dorë nga pjesa e trashëguar dhe atë duke u bazuar në nenin 135, par.1 të LTK-së, i cili thotë se *“Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi ose për pranimin e trashëgimit nuk mund të revokohet”*.

Ndërsa në Ligjin për pronësinë dhe të drejta tjera sendore saktësisht në nenin 36 par.1 thuhet se *“Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”* ndërsa në par.2 thuhet *“Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente”*

Sipas nenit 18 par.1 të LPK-së i cili thotë se *“Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”*.

Andaj, duke u bazuar nga arsyet dhe faktet e prezantuara më lartë, kjo gjykatë konsideron se mënyra e bartjes së pronësisë nga një subjekt në subjektin tjetër mund të kryhet në procedura tjera jashtë gjyqësore dhe nuk është çështje që mund të zgjidhet në procedurë gjyqësore.

Andaj, nga të lartcekurat, e konform nenit 18 par.1, dhe 387 pikë w, të LPK-së, në lidhje me nenin 3 të LPJ-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
CN.nr.14/2023, më 04.06.2024

Gj y q t a r i
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.